



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2019:102027  
Datë: 22.10.2024  
Numri i dokumentit: 06334652

**K.DH.SH.II.nr.1828/2024**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit NTP “Interbaj” me seli ne Ferizaj, kundër te paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike padi për shpalljen e palejueshëm te ekzekutimit te vendimit, duke vendosur lidhur me konfliktin për kompetencë ndërmjet Dhomave te Shkalles se parë, Departamenti për Çështje Fiskale dhe Departamenti Ekonomik i Gjykatës Komerciale të Kosovës në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 21.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Për të gjykuar në këtë Çështje juridike kompetenca lëndore është Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles të Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, të cilës i dërgohen shkresat e lendes në procedurë të mëtejshme.

II. Kundër këtij aktvendimi ankesa është palejueshme ne kuptim te nenit 26.3 te LPK

**A R S Y E T I M**

Paditësi me dt. 13.12.2018 në Gjykatën Themelore ne Ferizaj, ka ushtruar padi kundër te paditurës Dogana e Kosovës, me te cilën ka kërkuar qe te shpallet i palejueshëm ekzekutimi ne procedure përmbartimore i lejuar nga Gjykata Themelore ne Ferizaj, sipas aktvendimit E.nr.1330/10, te datës 20.11.2020. Pas themelimit te Gjykatës Komerciale, lënda është bartur për vendosje për te gjykuar, pranë kësaj gjykate, si gjykate kompetente.

Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik Fiskal me vendimin KE.nr.2395/22 ka vendos se kompetent për trajtimin e kësaj çështje juridike për shpalljen e palejueshëm te ekzekutimit te vendimit është Departamenti për Çështje Fiskal i Gjykatës Komerciale.

Me Aktvendimin nr. KF.nr.49/23 të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Fiskale, ka hap konflikt për kompetence në Gjykatën Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, përkitazi me kompetencën lëndore, ne këtë kontest duke vlerësuar se ne kuptim te nenit 13 para1.1 te Ligjit për gjykatën Komerciale nr. 08/L-15 *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: neni 1.11. kontestet administrative nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës tatimore të Kosovës, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve tjera shtetërore.*

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale pas shqyrtimit te shkresave të lëndës ka gjetur se në këtë çështje juridike kompetencë lëndore për të vendosur është Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Ekonomik, për arsye se, në bazë të nenit 13 paragrafi 1 pika 1.11 lidhur prag 4 te këtij të ligji për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-15 shprehimisht është përcaktuar se Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale të Kosovës është kompetent me gjykuar në shkallë të parë: *“1.11. kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore”.*

Andaj, në rasti konkret Kolegji vlerëson se ne baze te shkresave rezulton se kontesti ne këtë çështje është iniciuar nga pala paditëse me pretendimin qe te shpallet i palejueshëm aktvendimi përmbarimor, te cilin e ka marre Gjykata Themelore ne Ferizaj, e qe mban shenjen E.nr.1330/10 te datës 20.11.2012, e ku nga shkresat e lendes kjo gjykate konstaton se procedura përmbarimore është zhvilluar mbi bazën e dokumentit përmbarimor, te nxjerre nga Dogana e Kosovës.

Prandaj si përfundim Kolegji i kësaj gjykate konsideron se kjo çështje duhet të gjykohet nga Departamenti Ekonomik i Gjykatës Komerciale, si departament kompetent për te gjykuar kontestet ndërmjet personave juridik, ne kuptim te nenit 13 par1.1 te Ligjit per Gjykatën Komerciale.

Ngase u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 13 nen parag 6 i Ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-15 dhe 25 te LPK, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.1828/2024 datë 21.10.2024**

**Kryetari i Kolegjit – gjyqtari  
Faton Bajrami d.v**